V E N D I M
Nr. 350, datë 28.7.1999

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCENSION TË MINIERAVE TË KROMIT NË VLAHNA, PEROLLAJ DHE KALIMASH, SË BASHKU ME FABRIKËN E PASURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Minierat e kromit në Vlahna, Perollaj dhe Kalimash, së bashku me fabrikën e pasurimit, t'i jepen me koncension shoqërisë turke "Hayri Ogelman Mademcilik", sipas projektit të pakërkuar, propozuar nga kjo shoqëri.
2. Forma e kontratës koncensionare të jetë BOT (ndërtim, shfrytëzim, transferim).
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit si organi i autorizuar shtetëror për negociimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko